



VENDIM

Nr. 32 Datë 31.03.2011

**PËR
MOSFILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR
RINOVIMIN E LICENSËS SË SHOQËRISË “GSA” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTIRIKE**

Në mbështetje të nenit 9, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pikat 1 dhe 3, neni 16 pika 1 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 31.03.2011, mbasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “GSA” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi rinovimin e liçensës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

- Bazuar në vendimin nr. 79, datë 21.12.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k “Për rinovimin e liçensës në aktivitetin e importit të energjisë elektrike”, liçensa e subjektit “GSA” sh.p.k, për aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike ka përfunduar që në datën 26.01.2011 dhe aktualisht subjekti nuk ka liçensë.
- Kërkesa për rinovimin e liçensës së këtij subjekti është paraqitur në ERE, në datën 17.03.2011, pra në mosrespektim të afatit të paraqitjes së kërkesës për rinovim të liçensës sipas nenit 16 pika 1, në të cilin përcaktohet se: **“Jo më vonë se 6 - muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së liçensës së dhënë, personi mund/duhet të kërkojë në ERE rinovimin e liçensës.”**

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të mosfillojë procedurat e shqyrtimit të aplikimit për rinovimin e liçensës së shoqërisë “GSA” sh.p.k, në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s
NE DETYRE
Entela Shehaj**



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIM

Nr. 32 Datë 31.03.2011

**PËR
MOSFILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR
RINOVIMIN E LICENSËS SË SHOQËRISË “GSA” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTIRIKE**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkelqim Bozgo	_____	_____